



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/27

Datë: 01.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për pezullimin e përkohshëm të Vendimit të Qeverisë nr. 04/20 të datës 20.12.2017

1. Vendimi i Qeverisë nr. 04/20 i datës 20.12.2017 pezullohet përkohësisht deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese për rastin e regjistruar në regjistrin përkatës të Gjykatës KO12/18 në Njoftimin Nr. Ref.:KK11/18 të datës 30 janar 2018.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/27
Datë: 01.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Gjykatat.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ
Ramush Haradinaj
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/27

Datë: 01.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/27
Datë: 01.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/27

Datë: 01.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/27
Datë: 01.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 04/L-141 për Provimin e Jurisprudencës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Aleksandër Lumezi - kryetar i komisionit, pyetës i lëndës e drejta Penale, dhe zëvendës anëtar i komisionit z. Besim Kelmendi;
 - 1.2. Prof. Dr. Haxhi Gashi - anëtar i komisionit, pyetës i lëndës E drejta Civile (materiale dhe procedurale), dhe zëvendës anëtar Albert Zogaj;
 - 1.3. Prof. Dr. Nebojsa Boriqiq - anëtar i komisionit, pyetës i lëndës E drejta Tregtare, dhe zëvendës anëtar Gazmend Nushi;
 - 1.4. Afërdita Bytyçi - anëtar i komisionit, pyetës i lëndës E drejta Kushtetuese, organizimi i sistemit gjyqësor të Kosovës, bazat e sistemit të Bashkimit Evropian dhe të Drejtat e Njeriut, dhe zëvendës anëtar Qerim Fazliji;
 - 1.5. Enver Peci - anëtar i komisionit, pyetës i lëndës E drejta e Punës dhe E drejta Administrative, dhe zëvendës anëtare Emine Kaçiku.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 05/09 i datës 20.10.2017.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 07/27

Datë: 01.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës i propozon Presidentit të Republikës së Kosovës emërimin e z. Arbër Vllahiu në pozitën e të ngarkuarit me punë në Misionin Diplomatik në Pragë/Republikën e Çekisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/27
Datë: 01.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 dhe 8 të Ligjit nr. 03/2011 për Rrugët dhe nenit 3 të Ligjit nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për Rrugët, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Infrastrukturës për emërtimin e segmentit të Rrugës Nacionale Prishtinë - Mitrovicë në gjatësi prej 35 km, me emrin "Rruga e Tre Heronjëve Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha".
2. Obligohet Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkërendim të marrin masat për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ
Ramush Haradinaj
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/27

Datë: 01.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Presidenti i Republikës së Kosovës ftohet që, në vigjilje të dhjetëvjetorit të Pavarësisë së Vendit, t'i drejtohet Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/27
Datë: 01.02.2018


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Grupit punues për hartimin e Strategjisë për mbështetje të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

1. Themelohet Grupi punues për hartimin e Strategjisë për mbështetje të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, kryesues;
 - 1.2. Zyra për Planifikim Strategjik/ZKM, bashkëkryesues;
 - 1.3. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, anëtar;
 - 1.4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, anëtar;
 - 1.5. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, anëtar;
 - 1.6. Ministria e Financave, anëtar;
 - 1.7. Ministria e Integrimit Evropian, anëtar;
 - 1.8. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtar;
 - 1.9. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar;
 - 1.10. Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, anëtar;
 - 1.11. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;
 - 1.12. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, anëtar.
2. Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë caktohet institucion udhëheqës në procesin e hartimit dhe Strategjisë në fjalë dhe obligohet që të ofrojë mbështetjen e duhur për Grupin Punues.
3. Grupi Punues ka për detyrë të hartojë Strategjinë për mbështetje të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe Planit të saj të Veprimit, e cila duhet të dorëzohet për miratim në Qeveri.
4. Sipas nevojës dhe në bazë të vlerësimeve të Kryesuesit dhe anëtarëve të Grupit Punues, anëtarë të tjerë nga institucione tjera dhe përfaqësues të organizatave relevante të shoqërisë civile, bizneset dhe shoqatat përkatëse të fushës mund t'i shtohen këtij Grupi Punues.

5. Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë gjithashtu kërkon nga të gjitha Ministrinë dhe institucionet tjera t'i kryejnë obligimet e parapara me këtë vendim, të bashkëpunojnë me Grupin Punues dhe t'iu përgjigjen kërkesave të Grupit Punues.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/27

Datë: 01.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për t'i rekomanduar Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për nënshkrimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Sigurime Sociale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Belgjikës.
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në pajtim me afatin e përcaktuar në Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë